



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. ____/____Prot.

Fier, më 11.08.2022

Lënda: Formulari i njoftimit paraprak të fituesit për procedurën me objekt “**Mirëmbajtja me sistem vaditje automatik e sipërfaqeve të gjelberta dhe skarpateve buzë lumit Gjanica**”, me burim financimi nga buxheti i Bashkisë Fier.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË
(për botim)

Shtojca 12

BASHKIA FIER

Data: 11.08.2022

Drejtuar: Operatorit ekonomik “SARDO” shpk

Adresa: Lagjia “Apollonia”, Rruga “Jakov Mile” ,Fier

NUIS K13120402W

*** * ***

Procedura e prokurimit: E hapur e thjeshtuar me mjete elektronike, me objekt “**Mirëmbajtja me sistem vaditje automatik e sipërfaqeve të gjelberta dhe skarpateve buzë lumit Gjanica**”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-36953-07-22-2022.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Mirëmbajtja me sistem vaditje automatik e sipërfaqeve të gjelberta dhe skarpateve buzë lumit Gjanica**”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave prej **4 701 217,08** (*kater milion e shtateqind e nje mije e dyqind e shtatembedhjete presje zero tete*) **lekë pa TVSH**, me burim financimi nga buxheti i Bashkisë Fier, në përputhje me preventivat, sasitë, specifikimet teknike, termat e referencës dhe kushtet e përcaktuara në DST.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: **4 (kater) jave (sipas grafikut te punimeve).**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [01 Gusht 2022], [Numri 106].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik MODESTE SHPK numri i NUIS J62903413B .Vlera totale sipas formularit të ofertës është 4 578 113.40 (kater milion e peseqind e shtatedhete e tete mije e njeqind e trembedhete pike dyzet) lekë pa TVSH. - afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
2. Operatori ekonomik “SARDO” sh.p.k numri i NUIS K13120402W .Vlera totale sipas formularit të ofertës është 4 100 000 (kater milion e njeqind mije) lekë pa TVSH. - afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

Nga pjesërmarrësit është skualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

Operatori Ekonomik “Modeste” sh.p.k. skualifikohet per arsye se:

1. Në formularin e vetëdeklarimit në pikën 8,9,10 OE ka plotësuar opsionin ‘JO’, duke e plotësuar në mënyrë kontradiktore vetëdeklarimin lidhur me pavarësinë e ofertës në pikën 6 ku ka plotësuar opsionin ‘PO’.

Në nenin 4, pika 1 të ligjit nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", parashikohet se:

“1. Ndalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që:

- a) caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;*
- b) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;*
- c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;*
- ç) në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;*
- d) kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave”*

Në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.”

Nga shqyrtimi i formularit të vetëdeklarimit të paraqitur, konstatohet se në seksionin B “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”.OE ka përcaktuar opsionin “PO” në pikën gjashtë, duke

deklaruar se ka përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër. Ndërsa në pikat 8, 9 dhe 10, ankimuesi ka përcaktuar opsionin “JO” për pohimet se “nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me çmimet; metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit; qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës”.

“Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës.” “Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.”

Sa më sipër, Komisioni i Vleresimit të Ofertave ka konstatuar se OE e ka plotësuar në mënyrë kontradiktore vetëdeklarimin lidhur me pavarësinë e ofertës, pasi nga njëra anë në pikën 6 është deklaruar se e ka përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër, nga ana tjetër nuk është miratuar nëpërmjet opsionit “PO” pohimet standarde në seksionin B të vetëdeklarimit. K.V.O.ka gjykuar se formulari i vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit, nuk është plotësuar në mënyrë të qartë dhe të saktë, duke mosgarantuar përmbushjen e detyrimeve ligjore të parashikuara në nenin 4, pika 1 të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, gjatë hartimit të ofertës nga ana e OE.

2. OE nuk plotëson kriterin 2.3.1 “Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën”:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **1 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 30% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më pak se **4 000 000 leke pa tvsh** (e cila është një vlerë jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet).

Për plotësimin e këtij kriteri OE ka paraqitur ‘Kontratë Sipërmarrje Nr.43/231/2016 me objekt “Ripërtëritje Urbane e Bulevardit ‘Ramiz Aranitasi’” Nr.5822/6 Prot., datë 30.11.2016, me Autoritet Kontraktor Bashkia Fier, të cilën e keni përfituar si Bashkim i Përkohshëm Operatorësh me “G.P.G.Company” sh.p.k.

Në kontratën për bashkimin e përkohshëm të shoqërive me Nr.2074Rep., Nr.774 Kol., datë 08.10.2016, Neni 3 ‘Pjesëmarrja në zbatimin e kontratës’ OE do të zbatojë vetëm 19% të punimeve dhe konkretisht:

- **Punime gjelbërimi dhe sinjalistike**

- 1.F.V Fidane Pemë Dekorative
- 2.F.V Fidane shkurre dekorative Oleandër
3. F.V Fidane lule dekorative

- **Punime për rehabilitimin e fasadave**

1. Suva e zakonshme mur tulle h=8m
2. Suva e zakonshme mur tulle h>8m
3. Shkallë montazhi mermeri (parrmak dritare t=2cm)
4. Pllakë b/a granili mbi parapet tarrace.
5. Veshje muri me një shtresë pllakë gipsi.
6. F.V zgara dekorative hekuri me figuracion dekorativ(kangjellat).
7. Parapet ballkoni me tuba inoksi ngjyrë e verdhë ose metalizato h=80-90 cm.
8. Parapet ballkoni me tuba inoksi ngjyrë e verdhë ose metalizato h=30-50 cm.
9. Bojë vaji sipërfaqe metalike (për kangjellat ekzistuese).
10. Bojë hidroplastike importi cilësi e parë.
11. Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm+rrjetë+suva.
12. F.V kolonë gipsi me përmasa 13x30cm.
13. Suvatim me grafiato h>4m.
14. Konstruksione metalike të thjeshta (fasada me rrjetë).
15. F.V hijëzues alumini.

Asnjë nga zërat e mësipërm, të cilët OE ka realizuar në përputhje me kontratën e përkohshme të bashkëpunimit, nuk është e ngjashme me objektin tonë të prokurimit **“Mirëmbajtja me sistem vaditje automatik e sipërfaqeve të gjelberta dhe skarpateve buzë lumit Gjanica”**, pasi ne pjesën e parë janë punime gjelbërimi ndërsa në pjesën e dytë janë punime fasadash të objekteve që ndodhen në të dyja anët e rrugës.

Bazuar në nenin 82, pika 2, paragrafi i dytë i V. K .M.-se nr.285 date 19.05.2021 *“Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”*, e ndryshuar, në të cilin citohet:

2. *Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi që oferta e OE “Modeste” sh.p.k. të skualifikohet për arsyet e mësipërme.

*** * ***

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“SARDO”shpk**, numri i NUIS: **K13120402W**, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **4 100 000** (kater million e njeqind) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit, sipas përcaktimeve në nenin 109 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ZYRTAR I AUTORIZUAR
Zv.Kryetari

Andius OLLDASHI